
**ECONOMIC DEVELOPMENT AND THE CONSEQUENCES OF MIGRATION
ACCORDING TO NEWSPAPER “ALBANIA”**

Albnora Musa Bakiu

University of Tetovo, North Macedonia, albnora.musa@unite.edu.mk

Hiriet Ziberi

University of Tetovo, North Macedonia, hiriet.ziberi@unite.edu.mk

Abstract: Faik Konica, this prominent figure of Albanian culture has indisputable merit for the contribution he has brought to many fields of knowledge. The first contributions to popular culture and local traditions can be found in the years of his youth, when he was publishing the well-known newspaper "Albania". An impetus to pay attention to Albanian culture was his strong feelings of love for the land of his ancestors, where he expresses his spiritual ties to the homeland. Konica in all his ways has poured his many knowledge on the country and the people, skillfully interweaving them with general historical-geographic data and especially with rich materials collected with care and competence. Having an appreciative and kind attitude towards his country, Konica could not agree with the attitude of some category of people in Albania, who denied and degraded everything that was Albanian, took the traditions and customs of the country under their feet and had inferiority complex before foreigners and took the path of exile. Faik Konica treated exile, a phenomenon that has always accompanied Albanians. He was fully convinced that Albanians should do the impossible and continue living in their territories inherited from their ancestors. He criticized exile and was against the departure of Albanians who saw it as an easier way for economic benefits. He based his position on the fact that the economic branches in Albania were not like before, they had had a noticeable rise. Despite the economic growth, he was also aware of the problems faced by the Albanians and for this he blamed the Ottoman Empire, which charged them with many taxes and did not want the economic life in Albania to increase, so that the Albanians would not earn their income and to get out of the poverty they were in. He also pointed his finger at all the neighbor countries that interfered in Albania's internal affairs and did not allow the Albanians to enjoy the profits from farming, livestock, and trading, and as a result, the Albanians stopped working their lands, and as a better choice they saw leaving and cultivating foreign lands. Analyzing the different European countries, Konica emphasized that an effort should be made to improve the economic branches in Albania even more and to benefit from it. Only with the improvement of trade, agriculture and livestock conditions would a country flourish and move forward, therefore, according to Konica, young Albanians had to take care and understand the needs of the homeland. This is because the progress, civilization and prosperity of a country were closely related to the development of economic branches, so this would be an impetus for young Albanians to stay more in their homeland and their contribution would be in the homeland, and not give their contribution to foreigners.

Keywords: Faik Konica, newspaper, migration, economic development, etc.

**ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PASOJAT E MIGRIMIT SIPAS REVISTËS
“ALBANIA”**

Albnora Musa Bakiu

Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut, albnora.musa@unite.edu.mk

Hiriet Ziberi

Universiteti i Tetovës, Maqedonia e Veriut, hiriet.ziberi@unite.edu.mk

Abstrakt: Faik Konica, kjo figurë e shquar e kulturës shqiptare ka merita të padiskutueshme për kontributin që ka sjellë në shumë fusha të dijës. Kontributet e para për kulturën popullore dhe për traditat vendase i gjejmë qysh në vitet e rinisë së tij, në kohën kur botonte revistën e mirënjohur “Albania”. Një shtytje për ti kushtuar vëmendje kulturës shqiptare ishin ndjenjat e tij të thella të dashurisë për vendin e të parëve, ku i shpreh lidhjet e tij shpirtërore ndaj atdheut. Konica në të gjitha mënyrat e tij ka derdhur njohuritë e tij të shumta mbi vendin dhe njerëzit, duke i gërshetuar me mjeshtri me të dhëna të përgjithshme historike-gjeografike dhe sidomos me materiale të pasura të vjelura me kujdes e kompetenc. Duke pasur ai vetë një qëndrim vlersues e dashamirë për vendin e tij Konica nuk mund të pajtohej me qëndrimin e një kategorie njerëzish në Shqipëri, të cilët mohonin e degradonin çdo gjë që ishte shqiptare, merrnin nëpër këmbë traditat e zakonet e vendit dhe kishin një kompleks inferioriteti përpara të huajve dhe merrnin rrugën e mërgimit.

Faik Konica trajtonte mërgimin, një dukuri kjo që i ka shoqëruar çdoherë shqiptarët. Ai kishte bindjen e plotë se shqiptarët duhet të bënin të pamundurën dhe të vazhdonin të jetonin në territoret e tyre të trashëguara nga stërgjyshërit. Kritikonte mërgimin dhe ishte kundër largimit të shqiptarëve të cilët e shikonin si rrugë më të lehtë për përfitime ekonomike. Këtë qëndrim të tij ai e mbështet në faktin se degët ekonomike në Shqipëri nuk ishin si më parë ata kishin pasur një ngritje që binte në sy. Përkundër rritjes ekonomike ai ishte i vetëdijshëm edhe për problematikat që hasnin shqiptarët dhe për këtë ai fajësonte shumë Perandorinë Osmane e cila i ngarkonte me taksa të shumta dhe nuk dëshironte që të rritet jeta ekonomike në Shqipëri, që shqiptarët të mos fitonin të ardhurat e tyre dhe të dilnin nga varfëria ku ndodheshin. Ai gishtin drejtonte edhe kundrejt të gjithë shteteve fqinje të cilat ndërhyjnë në çështjet e brendshme të Shqipërisë dhe nuk e lejonin që fitimet nga kultivimi i bujqësisë, blegtorisë, tregtisë t'i gëzonin shqiptarët e si pasojë shqiptari filloi që më as nuk i punonte tokat e tij dhe si zgjedhje më të mirë e shikonte largimin dhe punimin e tokave të huaja. Duke analizuar vendet e ndryshme europiane, Konica theksonte që do duhej të bëhej një përpjekje për tu përmirsuar edhe më shumë degët ekonomike në Shqipëri dhe të përfitohen të mirat prej saj. Vetëm me përmirsimin e kushteve të tregtisë, bujqësisë dhe blegtorisë do të lulëzonte një vend dhe do ecte përpara prandaj të rinjtë shqiptarë sipas Konicës duhej të përkujdesen dhe të kuptojnë nevojat e atdheut. Kjo pasi që përparimi, qytetërimi dhe lulëzimi i një vendi ishin të lidhura ngushtë edhe me zhvillimin e degëve ekonomike andaj kjo do të ishte një shtysë që të rinjtë shqiptar të qëndronin më tepër në vendlindje dhe kontributi i tyre të ishte në atdhe dhe jo kontributin e tyre ta jepnin në dhe të huaj.

Fjalët kyçe: Faik Konica, revista, migrimi, zhvillimi ekonomik, etj.

1. HYRJE

Virtytet e një populli qofshin të mira apo të këqija janë ato që definojnë një komb. Populli shqiptar si një nga popujt më të lashtë padiskutim që ka virtyte me të cilat mund të krenohet dhe mburret para popujve të tjerë. Duke ditur se gazeta “Albania” trajtonte çdo element në rreshtat e saj gjejmë edhe kultivimin e degëve ekonomike ku shqiptarët paraqiten si puntorë të mirfilltë sidomos të bujqësisë, blegtorisë dhe tregtisë. Mirëpo në gazetë nuk anashkalohej edhe një temë tjetër që paraqet një plagë të motshme të shqiptarëve, migrimi. Luftërat shekullore pushtuese, grabitqare, të armiqve të ndryshëm kundër truallit shqiptar, pastaj shtypja dhe shfrytëzimi i egër e i pamëshirshëm feudal si dhe rrënimi i vazhdueshëm i ekonomisë së vendit dhe popullit, shkaktoin para dhe gjatë tërë sundimit osman që mijëra shqiptarë të merrnin rrugën e migrimit. (Salihi, A. (2024). Kushtet e dobta të jetesës, mungesa e perspektivës ekonomike, arsimore dhe hendeku në rritje dhe zhvillim midis vendeve të pasura dhe të varfëra. Të gjithë këta faktorë janë dhe kanë qenë indikatorë të fuqishëm për largimin e njerëzve nga vendlindja. Arsyet për migrimin e individëve kanë qenë të shumta duke përfshirë këtu edhe motivimin politik, ekonomik, shoqëror etj. (Memeti, D; Abduli, A; Ziberi, H; (2019). Në këtë rast Faik Konica na iluminon me kushtet e vështira politike, ekonomike, arsimore, kulturore nga ana e Perandorisë Osmane që ushtronte mbi shqiptarët të cilët si opion zgjedhjeje shihnin migrimin. Duhet theksuar gjithashtu se migrimi nuk përfundon me përfundimin e botimit të “Albania-s” ose edhe të shpalljes së pavarësisë. Duke marrë shkas nga përfundimi i luftërave ballkanike që të vetmit që nuk përfituan asgjë por shkuan deri aty që ishin ata që humbën më tepër, dhe duke përjetuar këtë humbje ata zgjidhnin migrimin. (Idrizi, M. (2024). Gjithsesi, aspekti i lëvizjes së popullatës në Ballkan gjatë shek. XIX-të lëvizje kjo e cila ka përcaktuar hapsirën territoriale të zhvillimit të çështjes shqiptare, megjithatë mund të konkludojmë këtu se territori i Ballkanit gjatë shk. XIX-të ka pasur një realitet tërësisht të ndryshëm nga ky realitet që njohim ne sot. (Arifi, T. (2024).

2. ZHVILLI EKONOMIK NË SHQIPËRI SIPAS GAZETËS “ALBANIA”

Ashtu si një pjesë e atdhetarëve shqiptar edhe Faik Konica ka pasur si detyrë kryesore njohja e Shqipërisë nga opinioni botëror. Në këtë drejtim ai ka bërë luftën më të madhe në çdo cep të botës në të cilën është gjindur, prandaj me shumë vendosshmëri potencon, se kjo gjë e rëndësishme është detyrë politike në njërën drejtim dhe detyrë patriotike në drejtimin tjetër. Me njohjen e botërore të një populli, ai faktorizohet në arenën gjithëmbarshe. (Memedi, Sh. (2024).

Një tematikë që shtjellohej në fletët e gazetës “Albania” ishte kultivimi i degëve të ndryshme ekonomike. Bagëtia do të ishte një degë e cila nuk kultivohej pothuajse aspak në Shqipëri, pasi bagëtitë pësonin shpesh sëmundje të ndryshme kurse njerëzit fatkeqësisht nuk mundeshin të bënin asgjë. Në përgjithësi, kafshët shtëpiake nuk kultivoheshin shumë dhe ajo që deri diku ishte e përhapur ishte lopa. Duke analizuar vendet e ndryshme europiane, Konica theksonte që do duhej të bëhej një përpjekje për tu përmirsuar bagëtia në Shqipëri dhe të përfitohen të mirat prej saj. Vetëm me përmirsimin e kushteve të tregtisë, bujqësisë dhe blegtorisë do të lulëzonte një vend dhe do ecte përpara prandaj të rinjtë shqiptarë sipas Konicës duhej të përkujdesen dhe të kuptojnë nevojat e atdheut. Kjo pasi që përparimi, qytetërimi dhe lulëzimi i një vendi ishin të lidhura ngushtë edhe me zhvillimin e degëve ekonomike. (Albania, (1897/8, 31 Mars-31 Mars). Sa u përket pyjeve të Shqipërisë po zbrazeshin nga të prerat e drunjve pa u

kushtuar kujdes se sa dhe deri ku duhet prerë. Kurse industria ishte një degë e cila nuk shihej asgjëkundi në Shqipëri. Sa i takon tregtisë ajo shihej si një degë e cila premtonte shumë për të ardhmen pasi tregtarë të mirëfilltë kishte në Shkodër, Tiranë, Janinë, Berat, Durrës, Vlorë, Prevezë dhe Gjirokastrë. Vendet me të cilat bëhej më tepër tregti rradhiteshin Austria, Italia, Perandoria Osmane dhe në fund disa shtete të tjera të Europës. Kurse sa i përket bujqësisë, ndonëse me një tokë pjellore, sipas një studimi që ishte realizuar në Shqipëri, vetëm 10% e tokës pjellore punohej në Shqipëri kurse 90% e saj mbetej e papërpunuar. Pjesa e vogël që punohej mbillej me misër dhe grurë dhe një pjesë e madhe e saj importohej në Mal të Zi, Austri dhe Perandori Osmane. Fatkeqësia e tokës pjellore sipas Faik Konicës qëndronte në atë se këtë pjesë të vogël të tokës pjellore e shfrytëzonte Mali i Zi. Ai kritikonte se si mundet që përfitimet e tyre shqiptarët t'ia jepnin armikut dhe këto të fundit të shesin pasta në Shqipëri me çmime shumë të larta. Për këtë situatë shkakun kryesor e gjente tek mospasja e një qeverie, ku mes tjerash theksonte: *“Të kishte pasur një qeveri Shqipëria do e çlironte veriun e vendit, do e shpëtonte dhe drithin dhe do vendoste një çmim mbi të gjithë drithin që del jashtë Shqipërisë, por e keqja qëndronte se kishte një të tillë për ta realizuar këtë punë”*. (Albania, (1903). Përkundër gjendjes jo shumë të mirë Shqipëria përsëri arrinte që të realizonte tregti edhe atë me import-eksport. Nga ata që eksportoheshin nga Shqipëria jashtë dhe kryesisht në Austro-Hungari, Itali por edhe në vende të tjera më së shumti do të ishin leshi, lëkura kurse ata të cilat importoheshin në brendësi të territoreve shqiptare do të ishin vaji i gurit, pëlhurat, ngjyrat. (Albania, (1905) Nga të gjitha degët që elaboruam duhet theksuar se degët ekonomike më të kapshme për shqiptarët ishin bujqësia dhe tregtia. Te këto dy degë vraponin si të pasurit ashtu edhe të varfërit pasi që kur punohej mirë toka, shitej mirë drithi kuptohet se edhe bujku paguhej më mirë por edhe i zoti fitonte më tepër. Mirëpo, fatkeqësisht të dy degët nuk ishte se kishin ndonjë zhvillim të theksuar dhe kjo shihej si shkas i varfërisë së tepërt në Shqipëri. (Albania, (1897, 28 Shkurt-28 Fevruar).

Ndonëse shihej një vend që premtonte shumë në disa degë ekonomike e keqja ishte se ajo asnjëherë nuk arriti përfitime të shumta në aspektin ekonomik. Do të ishte kjo një çështje që i preokuponte shumë një pjesë të madhe të popullsisë, e sidomos shtresën e lartë të arsimuar shqiptare që asnjëherë nuk arritën të kuptonin se si vendi i tyre i begatshëm nga natyra mbeti i varfër nga vullneti i qeverisë anadollake. Ato për këtë gjendje fajsonin Perandorinë Osmane e cila nuk dëshironte që të rritet jeta ekonomike në Shqipëri, që shqiptarët të mos fitonin të ardhurat e tyre dhe të dilnin nga varfëria ku ndodheshin. Fare mirë nga kjo mund të kuptojmë se kjo paraqiste një armiqësi të qeverisë osmane kundrejt tregtisë shqiptare. (Albania, (1907).

Nëse bëhej një paralelizëm mes asaj ku ishin shqiptarët më parë e ku ishin kur shkruhej gazeta kishte një ndryshim të madh sipas Konicës. Njëqind vjet më parë tregtia, bujqësia ishin në një lulzim të bukur. Marrëveshjet e tyre që i bënë realizoheshin në forma të lirë dhe jo si tani që i ndalonte një pjesë të madhe qeveria osmane duke i rënduar me taksa, kontrolle dhe me pyetje nëse mund edhe të fshihnin diçka. Më parë i varfëri e punonte tokën dhe shtrëngote të nxjerrë grur e bukë kurse sot njëmijë arsye dhe ndalesa që i nxirrte qeveria osmane kishin shkratur bujqësinë. Marrë shkas nga kjo, sipas Konicës, shqiptari filloi që më as nuk i punonte tokat e tija dhe si zgjedhje më të mirë e shikonte largimin dhe punimin e tokave të huaja. (Albania, (1901)

3. MIGRIMI

Faik Konica trajtonte edhe mërgimin, një dukuri kjo që i ka shoqëruar çdoherë shqiptarët. Ai kishte bindjen e plotë se shqiptarët duhet të bënin të pamundurën dhe të vazhdonin të jetonin në territoret e tyre të trashëguara nga stërgjyshërit. Kritikonte mërgimin dhe ishte kundër largimit të shqiptarëve të cilët e shikonin si rrugë më të lehtë për përfitime ekonomike. Ai theksonte se nëse punohej mirë dhe nuk toleronin që të huajt të përfitonin në tokën shqiptare ato do të mundnin që të jetonin mirë edhe në Shqipëri. Sipas Konicës: *ishte turp që shqiptarët të enden nëpër katër anët e botës kur ka mjaft të holla që mund të përfitohen edhe në Shqipëri*. Për më tepër ai këshillonte që edhe paratë e fituara të mos i harxhonin nëpër dyqane të huaja e sidomos të grekëve por të blinin tek vëllezërit e tyre shqiptar. Do të ishte një turp për një shqiptar nëse hynte diçka tek greku nëse krahas tij kishte një dyqan shqiptar. Ai ishte pro propagandës dhe theksonte se nëse kishte ndonjë vend ku mungonte ndonjë produkt do të ishte e udhës që të ftoheshin puntorë shqiptar nga vende të ndryshme për ta mbushur boshllokun që ishte tek vendi tjetër. (Albania, (1897). Se sa të drejtë kishte Faik Konica shohim edhe në një artikull të dërguar nga Stambolli ku një grup atdhetarësh ishin mledhur tok dhe kërkonin ndihmë nga shqiptarët për të ndihmuar bashkëkombasit e tyre në Stamboll. Disa shqiptarë si pasojë e gjendjes së vështirë ekonomike por edhe ndjekjeve të ndryshme ishin larguar nga Shqipëria mirëpo ëndrra e tyre nuk kishte përfunduar bukur për një jetë më të mirë. Një pjesë e shqiptarëve kishin ngelur pa punë, një pjesë tjetër ishin sëmure, qëndronin vetëm dhe të pa strehë, një pjesë dëshironin të ktheheshin përsëri në Shqipëri por nuk kishin mundësi. Duke parë raste nga më të ndryshmet një grup atdhetarësh kishin vendosur që të hapnin një arkë dhe të ndihmonin të gjithë shqiptarët e ngelur jashta territoreve shqiptare në kushte të këqija dhe me këtë do të dëshmonin një atdhedashuri. Krahas arkës ata mendonin se mund të krijonin edhe një shoqëri dhe kërkonin që gazeta Albania t'ia shpaloste lajmin aty se kjo shoqëri do të ndihmonte të gjithë shqiptarët të cilët veçse më ishin në Stamboll dhe mund t'i orientonte edhe të tjerët të cilët vinin për herë të parë dhe

nuk dinin asgjë për gjithë atë qytet të madh. (Albania, (1900). Ndonëse kishte shqiptar të cilët rrugën e mërgimit e kishin të vështirë por kishte dhe të tjerë të cilët e kishin pasur shumë më të lehtë rrugën e depërtimit. Të gjithë këto arritën që të inkuadroheshin në pozita të larta dhe punë të mira si pasojë e punës dhe karakterit të tyre të fortë të puntorit. E gjithë kjo nuk ngelej pa me u rënë në sy udhëtarëve e huaj të cilët shkruanin për shqiptarët se kishin një shije të hollë me një hije oborsie mbretërore dhe këtë mund t'a gjeje edhe tek një fshatar shqiptar por që sillej si një xhentelman i vërtetë. (Albania, (1909).

Përveç ngjarjeve të zeza që e karakterizonin popullsinë shqiptare dhe që paraqiteshin në gazetë një vend të posaçëm kishin edhe ngjarjet pozitive, festimet e festave të ndryshme qofshin ata myslimane ose të krishterëve. Duhet patur parasysh faktin se edhe këto ngjarje në artikujt e gazetës Albania trajtoheshin me një dozë melankolie duke ditur rrethanat në të cilët ndodheshin. Një shpjegim jepet për festën e Bajramit që festohet tek myslimanët pas një muaj agjerimi për muajin e Ramazanit dhe dritat e minares të lëna ndezur një ditë para Bajramit simbolizonte festën ditën e nesërme. Atë që dëshironte t'a paraqes Konica me anë të këtij artikulli ishte se ndër shqiptarët e të gjitha anëve kishte fytyra të venitura që nuk ndjenin fare gëzim në zemrat e tyre. Kjo ishte si pasojë se nuk mund të gjendej një shtëpi në gjithë Shqipërinë që të mos qanin për mungesë të ndonjë të dashuri që e kishin rekrutuar në ushtrinë osmane. (Albania, (1906).

4. PËRFUNDIM

Lidhur me të gjitha çështjet që arritën të trajtoheshin në gazetën "Albania", Konica arriti të ruajë të pacënuar personalitetin e tij, i cili shprehej në çdo situatë, pamvarsisht keqkuptimeve që mund të kishte nga të tjerët. Ajo që e bënte të veçantë këtë personalitet ishte se ai arrinte të depërtojë thellë në gjuhën e të tjerëve, të shkrihet në një mentalitet tjetër e përsëri ti mbetet besnik të vetit. (Sulejmani, F. (2014). Konica del në konkluzionin e rëndësishëm të karakterit sociologjik se zhvillimi i tregtisë, bujqësisë dhe tregtisë sjell sigurinë dhe përparimin shoqëror, mënjanimin e rrezikut të kusarisë e të grabitjeve, dukuri këto sociale që ishin shndërruar në plagë të shoqërisë shqiptare të kohës.

Pra Konica, çështjen e prodhimit bujqësor e blegtoral e sheh të lidhur ngushtë me tregtinë dhe sektorë të tjerë të zhvillimit shoqëror, duke theksuar se: "Tregtia, bujqësia, bagëtia janë gjaku, jeta, lulëzimi i një vendi dhe të rinjtë mëmëdhetarë duhet të përkujdesen për çështjet aq të dobishme e të rëndësishme, dhe të kuptojnë nevojat e mëmëdheut". Më pas ai vazhdon se: "Vërtet, është më lehtë të përpiqet njeriu për politikë, por përparimi, lulëzimi, qytetërimi janë më shumë të lidhura me punëz e ekonomisë se me fjalët e politikës". Konica e ka kështu më se të qartë rolin parësor e themelor që luan baza ekonomike në shoqëri, krahas rolit drejtues të strukturës nëpërmjet një politike atdhetare.

BIBLIOGRAFIA

Albania, 1897, 28 Shkurt-28 Fevruar, A, fq.165.

Albania 1897, Nga 25 të Prillit-Avril, A, fq.22.

Albania, 1897/8, 31 Mars-31 Mars, A, fq.184.

Albania 1899, C, Nga 15 gjer në 30 të korhikut. C, fq.122.

Albania, 1900, Viti IV, Num. 5. fq. 98.

Albania. 1901, kalëndor, nr. 1 fq. 6.

Albania 1903, H, Mars, fq. 34.

Albania, 1905, Vit 9, Nr. 10, fq. 197.

Albania, 1906, Viti 10, Nr. 2, fq. 35.

Albania, 1907, Viti 11, Nr. 3, fq. 50.

Albania, 1909, Viti 12, Nr.1, fq. 10.

Arifi, T. (2024). Migrimi në letërsinë dhe mendimin intelektual të rilindjes kombëtare shqiptare. Në *Ballkanologjia 6, Fenomeni i migrimit në rajonin e Ballkanit*. Shkup: Instituti i trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve, f. 171.

Idrizi, M. (2024). Migrimi i shqiptarëve drejt Anadollit mes dy luftërave botërore dhe politika turke për strehimin e tyre. Në *Ballkanologjia 6, Fenomeni i migrimit në rajonin e Ballkanit*. Shkup: Instituti i trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve, f. 32.

Memedi, Sh. (2024). Veprimtaria e palodhur në mërgim e Midhat Frashërit dhe Ismail Kadarese. Në *Ballkanologjia 6, Fenomeni i migrimit në rajonin e Ballkanit*. Shkup: Instituti i trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve, f. 219.

Memedi, D., Abduli, A., & Ziberi, H. (2019). Challenges of youth migration in the Republic of North Macedonia. Në *Knowledge, Vol.35.1. Skopje, f. 416.*

Salihi, A. (2024). Migrimet e popullsisë së Pollogut. Në *Ballkanologjia 6, Fenomeni i migrimit në rajonin e Ballkanit*. Shkup: Instituti i trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore të shqiptarëve, f. 140.

Sulejmani, F. (2014). Eseja- zhanër dominant në krijimtarinë e Faik Konicës. Në *Albanologji 4, Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 113-114.*